REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

**Njësia e Prokurimit**

Gjakovë, datë 30.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.09.2025, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.; ENERGY PLUS SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik", Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.; ENERGY PLUS SH.P.K., e dt.26.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik", Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 24.09.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:24.09.2025;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.; ENERGY PLUS SH.P.K, me dt.26.09.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik", Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.09.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pa bazuar sepse ju jo vetëm nuk keni plotësuar pjesën e formularit ku kërkohet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga lideri por edhe e keni fshirë këtë pjesë të formularit:

**Formulari në FDT:**

**Aneksi 8** **DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT**

**Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupi/apo konzorciumi që aplikon**

**Për:** [*shëno emrin e AK*]
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

**Në emër të:** [*shëno emrin e Grupit te OE*]
(në vazhdim "tenderuesi")

**Titulli i aktivitetit të prokurimit:** [*shëno titullim e Aktivitetit te prokurimit*]

**Numri i Prokurimit:** [*shëno numrin*]

Hyjnë ne bashkëpunim si Grup i Operatoreve Ekonomik , për qëllim të këtij tenderi me titull: [*shëno titullim e Aktivitetit te prokurimit*] me numër te prokurimit [*shëno numrin*].

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik në përbërje të anëtarëve të grupit:

*I.* ______________________________
*Shëno emrin e anëtarit të grupit - Liderit* *Shëno adresën*

dhe

II. ______________ ______________
*Shëno emrin e anëtarit të grupit* *Shëno adresën*

*shto sipas nevojës .....*

Datë: __/__/____

Vendi: ____________________

**Anëtarët e grupit lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë:**

a. **Ne të gjithë** anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

b. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

c. **Ne të gjithë anëtarët e grupit e** autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: *Shëno emrin e liderit të grupit*

d. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se **jemi të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

e. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % *(përqindjen)* e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës është:

*a) [Shëno % (përqindjen)* e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratë *se Liderit]*

*b) [Shëno % (përqindjen)* e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratë *e anëtarit]*

*Shto sipas nevojës ....*

f. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:

*a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit]*

*b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit]*

*Shto sipas nevojës ....*

g. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.

h. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** pranojmë që: nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me anëtarin e mbetur, nëse anëtari i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Emri i Operatorit Ekonomik ( **lider** ) ________________________________

Emri Mbiemri ______________________

Data/ Nënshkrimi/ Vula ____________________

Anëtaret e tjerë te grupit:

Emri i Operatorit Ekonomik (anëtar) ________________________________

Emri Mbiemri ________________________________

Data/ Nënshkrimi/ Vula ________________________________

*Shto sipas nevojës ....*

Emri Mbiemri ( Përfaqësuesi i autorizuar ) ________________________________

Data/Nënshkrimi / Vula ______________________________

**Formulari i prezantuar nga ju:**

*ANEKSI 8 DEKLARATA PËR THEMELIM TË GRUPIT*

Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupit/apo konzorciumit që aplikon

Për: KOMUNA E GJAKOVËS
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [*ENERGY PLUS SHPK & NIKA PRO ING SHPK* ]
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: [Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik]

Numri i Prokurimit: [632-25-7679-5-2-1/

Hyjnë në bashkëpunim si Grup i Operatoreve Ekonomik , për qëllim të këtij tenderi me titull: [Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik] me numër te prokurimit [632-25-7679-5-2-1].

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik në përbërje të anëtarëve të grupit:

*ENERGY PLUS SHPK 810837487* *BEHAR BEGOLLI, PRISHTINE*
*Shëno emrin e anëtarit të grupit - Lideri* *Shëno adresën*

dhe:

1. NIKA PRO ING SHPK 811052307 RR REXHEP BISLIMI FERIZAJ
*Shëno emrin e anëtarit të grupit* *Shëno adresën*

*shto sipas nevojës .....*

Data: _11_/09_/2025____

Vendi: ____________PRISHTINE ________

Anëtarët e grupit duhen bërë marrëveshje me të cilën deklarojnë:

a. Ne të gjithë anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet Kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

b. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

c. Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: *ENERGY PLUS SHPK*

d. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojmë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

e. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % *(përqindjen)* e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është;

*a) [Shëno 90 % (përqindjen)* e pjesëmarrjes në realizimin e kontratë *se Liderit]*
*b) [Shëno 10 % (përqindjen)* e pjesëmarrjes në realizimin e kontratë *e anëtarit]*
*Shto sipas nevojës ....*

f. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë përgjegjësinë e secilit anëtar;

*a) [LIDERI DO TI EKZEKUTON TE GJITHA FAZAT E PUNES*
*b) [ANTARI DO TA MBESHTET ME STAF PROFESIONAL DHE MJETE TJERA*
*Shto sipas nevojës ....*

g. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.

h. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** pranojmë që, nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me anëtarin e mbetur, nëse anëtari i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Emri i Operatorit Ekonomik ( lider ) ENERGY PLUS SHPK

Emri Mbiemri HALIM HALIMI

Data/ Nënshkrimi/ Vula 11.09.2025

Anëtarët e tjerë të grupit:

Emri i Operatorit Ekonomik (anëtar) NIKA PRO ING SHPK

Emri Mbiemri SHPEND MUSA

Data/ Nënshkrimi/ Vula 11.09.2025

*Nëse ka nevojë ....*

**Siq shihet nga formulari i FDT-ë është hequr pjesa ku shënohet lideri:**

**Emri Mbiemri ( Përfaqësuesi i autorizuar )** ______________________________

**Data/Nënshkrimi / Vula** ______________________________

Për këtë arsye oferta juaj është refuzuar si administrativisht e papërgjegjshme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;